

20130932228

L I G J
PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TË OBLIGIMEVE SIPAS
MARRËVESHJES SË NDËRMARRË DHE TË NDRYSHUAR PËR HUA PËR
PROJEKTIN PËR PËRMIRËSIMIN E RRJETIT RRUGOR EKZISTUES RAJONAL
DHE LOKAL, QË DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM - BANKËS BOTËRORE DHE NDËRMARRJES
PUBLIKE PËR RRUGË SHTETËRORE

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton përmbushjen e obligimeve dhe plotësimin e dispozitave të Marrëveshjes së ndërmarrë dhe të ndryshuar për hua të dedikuar për financimin e Projektit për përmirësimin e rrjetit rrugor ekzistues rajonal dhe lokal, që do të lidhet ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Bankës Botërore dhe Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore në shumë prej 70 000 000 euro, në afate dhe kushte të parapara në Marrëveshjen e ndërmarrë dhe të ndryshuar për hua, nëse Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore nuk i plotëson dhe servison obligimet nga Marrëveshja e ndërmarrë dhe e ndryshuar për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen në Marrëveshjen e ndërmarrë dhe të ndryshuar për hua, që do të lidhet ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Bankës Botërore dhe Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore për financimin e Projektit për përmirësimin e rrjetit rrugor ekzistues rajonal dhe lokal.

Neni 3

Të gjitha obligimet që rezultojnë nga Marrëveshja e ndërmarrë dhe e ndryshuar për hua nga neni 1 i këtij ligji si dhe servisimin e huas, do t'i kryejë Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen e ndërmarrë dhe të ndryshuar për hua.

Neni 4

Afati i pagesës së huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vite. Pagesa do të bëhet në 30 këste gjysmëvjetore që arrijnë për pagesë më 15 mars dhe 15 shtator çdo vit, duke filluar nga 15 shtatori 2013 përfundimisht deri më 15 mars 2028.

Shkalla e kamatës është LIBOR (për valutë euro) plus shtrirja variabile.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella që rezultojnë nga Marrëveshja e ndërmarrë dhe e ndryshuar për hua dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Dispozita kalimtare dhe të fundit

Neni 6

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për huamarrje të Republikës së Maqedonisë te Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore sipas Marrëveshjes për hua për Projektin për përmirësimin e rrjetit rrugor ekzistues rajonal dhe lokal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 84/2008).

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.